

## MJEKIM I MBIKËQYRUR NË KOMUNITET PËR PACIENTË NËN PARAGRAFIN 3

(Paragrafi 17A i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

1. Emri i pacientit	
2. Emri i personit përgjegjës për kujdesin tuaj ( “klinikisti përgjegjës”)	
3. Data e fillimit të mjekimit të mbikëqyrur në komunitet	

### Përse jam në mjekim të mbikëqyrur në komunitet?

Ju jeni në mjekim të mbikëqyrur në komunitet sipas paragrafit 17A të Aktit për Shëndetin Mendor 1983 sepse personi përgjegjës për kujdesin tuaj (klinikisti i juaj përgjegjës) mendon se ju jeni në gjendje të mirë për të lëshuar spitalin, por merakoset se nuk mund të vazhdoni me mjekimin tuaj, ose do të keni nevojë të pranoheni para kohe për mjekim të metejshëm.

Mjekimi i mbikëqyrur në komunitet do të thotë se ekipi për kujdesin tuaj kujdeset sa më shumë për t’ju mbajtur në gjendje të mirë pasi të dilni nga spitali, por nëse klinikisti i juaj përgjegjës mendon se ju përsëri keni nevojë për mjekim në spital, ju duhet të ktheheni në spital për të marrë mjekimin e duhur.

Klinikisti i juaj përgjegjës do të bisedoj me ju lidhur me marrëveshjet për mjekimin dhe kujdesin e duhur për çrregullimin tuaj mendor, pas lëshimit tuaj nga spitali .

### Ç’është urdhëri për mjekim në komunitet?

Urdhëri për mjekim në komunitet është një dokument të cilin klinikisti i juaj përgjegjës dhe një person profesional i aprovuar për shëndetin mendor duhet ta plotësojnë për të treguar se ju duhet të qëndroni në mjekim të mbikëqyrur në komunitet.

Personi profesional i pavarur për shëndetin mendor është një person i trajnuar posaçërisht për të vendosur nëse njerëzit duhet të mbahen në spital, sipas Aktit për Shëndetin Mendor.

## Çfarë ndodhë pas daljes nga spitali?

Klinicisti i juaj përgjegjës do të bisedoj me ju lidhur me atë se çfarë ndodhë në mjekimin e mbikëqyrur në komunitet.

Ju duhet t'i përmbaheni disa marrëveshjeve të caktuara lidhur me mjekimin tuaj, ose marrëveshje tjera, për t'ju ndihmuar të jetoni të sigurtë në komunitet dhe të mbaheni mirë. Këto quhen "kushte", dhe lejohen sipas paragrafit 17B të Aktit për Shëndetin Mendor.

Klinicisti i juaj përgjegjës dhe një person profesional i aprovuar për shëndet mendor duhet të pajtohen se këto kushte janë të përshtatshme dhe në bazë të tyre do t'ju caktojnë ndihmë të nevojshme që ti përmbaheni këtyre kushteve. Ju duhet të bisedoni me klinikistin tuaj përgjegjës nëse jeni të shqetësuar për ndonjë arsye lidhur me ato që kërkoheni ti bëni ose mos t'i bëni, gjatë mjekimit tuaj të mbikëqyrur në komunitet.

## Çfarë ndodhë nëse nuk i përmbahem këtyre kushteve?

Nëse nuk i përmbaheni kushtit, ekipi për kujdesin tuaj duhet të mendoj nëse keni nevojë të riktheheni në spital për mjekim.

Ju duhet të vini nëse klinicisti i juaj përgjegjës mendon se kjo është e vetmja rrugë për t'ju siguruar mjekim të nevojshëm. Në disa raste kjo është e nevojshme edhe nëse j'u keni përmbajtur të gjitha kushteve. Kjo quhet "rikthim" në spital.

Nëse klinicisti i juaj përgjegjës mendon se ju duhet të riktheheni në spital, ai do t'ju njoftoj me shkrim se ju duhet të vini në spital menjëherë ose në një kohë të caktuar. Nëse nuk vini sipas kërkesës së tyre, ka mundësi që ata t'ju kthejnë kundër vullnetit tuaj.

Nëse ju rikthejnë në spital, juve mund t'ju mbajnë deri në 72 orë. Nëse klinicisti i juaj përgjegjës mendon se ju duhet të rrini më gjatë në spital, një person profesional i aprovuar për shëndetin mendor do të flas me ju. Kjo do t'ju shpjegohet atëherë.

## Çfarë mjekimi duhet të kem gjatë mjekimit të mbikëqyrur në komunitet?

Klinicisti i juaj përgjegjës do të diskutoj nevojat e mjekimit tuaj dhe do të zgjidh mënyrën se si do të mjekoheni në komunitet.

## A mund të refuzoj mjekimin?

Ju keni të drejtë të refuzoni mjekimin nëse nuk e dëshironi, por kjo do të thotë se klinicisti i juaj përgjegjës duhet të merrë parasysh rikthimin tuaj në spital.

Nëse nuk e dëshironi mjekimin e propozuar, ju duhet të bisedoni me klinikistin tuaj përgjegjës sa më parë.

## Ç'ndodhë nëse jam shumë i sëmurë për të marrë vendim për mjekimin tim?

Nëse personat që ju mjekojnë juve mendojnë se ju mungon kapaciteti për të vendosur për veti se a duhet të merrni mjekim, ata do t'ju ofrojnë mjekimin që mendojnë se ju nevojitet.

Por ata nuk mund t'ju shtyjnë të pranoni mjekimin të cilin e refuzoni, përveç nëse është rast urgjent.

“Mungesa e kapacitetit” do të thotë se për shkak të çrregullimit tuaj mendor, ju nuk jeni në gjendje t'i bëni një ose më shumë nga këto katër gjëra në vijim:

- Të kuptoni informacionin e dhënë lidhur me mjekimin
- Të mbani mend atë informacion një kohë të gjatë për të qenë gjendje të merrni vendim
- Të veni në balancë informacionin e dhënë kur të merrni vendim
- Të komunikoni vendimin tuaj në çfarëdo mënyre, siç është me anë të bisedës, gjuhës me shenja, ose edhe nëpërmes të lëvizjeve të thejshta, siç janë kapsitja e syve ose shtrëngimi i dorës.

Përveç në rast urgjent, juve nuk mund t'ju ofrohet mjekimi nëse ju e keni lidhur një marrëveshje paraprake me ligj për të refuzuar mjekimin sipas Aktit për Aftësi Mendore 2005 ose ndonjë person tjetër që ka të drejtë të merrë vendim në vendin tuaj sipas këtij Akti, dhe i cili thotë se ju nuk duhet ta bëni. Ky mund të jetë një person i autorizuar me ligj, një zëvendës i juaj i caktuar nga Gjykata e Mbrojtjes, ose vetë Gjykata e Mbrojtjes. Stafit i spitalit mund t'ju jep më shumë informacion lidhur me Aktin për Aftësi Mendore 2005.

## Rregulla të veçanta lidhur me mjekimin me medikamente dhe ilaçe

Pas qëndrimit në mjekim të mbikqyrur në komunitet më shumë se një muaj, kërkohen disa rregulla lidhur me mjekimin me medikamente dhe ilaçe.

Nëse jeni duke marrë mjekimin me medikamente dhe ilaçe dhe janë bërë më shumë se tre muaj që nga fillimi i marrjes së këtij lloj mjekimi gjatë qëndrimit në spital ose në mjekim të mbikqyrur në komunitet, ju duhet ta lejoni një mjek të pavarur (i cili nuk është nga spitali që ju mjekon juve) për t'ju ekzaminuar.

Mjeku i pavarur quhet SOAD (Mjek i caktuar për një mendim tjetër) dhe është i caktuar nga një Komision i pavarur i cili e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor.

Mjeku i pavarur e vlerëson nëse ky është mjekimi i drejtë për ju, dhe do të bisedoj me ju para se të vendos çfarë mjekimi duhet të vazhdoni të merrni.

Ju mund të merrni medikamente ose ilaçe vetëm nëse mjeku i pavarur thotë se kjo është e drejtë, përveç në rast urgjent.

Juve do t'ju tregojnë se kur dhe ku don t'ju ekzaminoj klinikisti i juaj përgjegjës. Një prej kushteve të mjekimit të mbikëqyrrur në komunitet është vizita e klinikistit të juaj përgjegjës për këtë ekzaminim. Nëse nuk e vizitoni klinikistin tuaj përgjegjës në kohë dhe vend të caktuar, atëherë klinikisti i juaj përgjegjës do t'ju rikthej në spital për t'ju ekzaminuar.

Ka rregulla të ndryshme për disa mjekime të veçanta, siç është terapia elektro-konvulsive (ECT). Nëse stafi mendon se ju keni nevojë për një nga këto mjekime të veçanta, do t'ju shpjegohen rregullat dhe do t'ju jepet një fletëpalosje tjetër.

### **Sa kohë duhet të qëndroj në mjekim të mbikëqyrrur në komunitet?**

Fillimisht, urdhëri i juaj për mjekim do të zgjasë deri në gjashtë muaj, përveç nëse në klinikisti i juaj përgjegjës vendos se kjo nuk është më e nevojshme.

Ju duhet ta lejoni klinikistin tuaj përgjegjës t'ju ekzaminoj nga fundi i gjashtë muajshit, për të parë nëse keni nevojë të vazhdoni me mjekimin e mbikëqyrrur në komunitet. Juve do t'ju tregojnë se kur dhe ku don t'ju ekzaminoj klinikisti i juaj përgjegjës.

Një prej kushteve të mjekimit të mbikëqyrrur në komunitet është vizita e klinikistit të juaj përgjegjës për këtë ekzaminim. Nëse nuk e vizitoni klinikistin tuaj përgjegjës në kohë dhe vend të caktuar, atëherë klinikisti i juaj përgjegjës do t'ju rikthej në spital për t'ju ekzaminuar.

Nëse klinikisti i juaj përgjegjës mendon se ju duhet të vazhdoni mjekimin e mbikëqyrrur në komunitet më gjatë, ata mund ta vazhdojnë edhe për gjashtë muaj të tjerë, dhe pastaj për nga një vit. Klinikisti i juaj përgjegjës do të bisedoj me ju lidhur me këtë nga fundi i çdo periudhe.

### **A mund të apeloj?**

Po. Ju mund të kërkonit nga Drejtuesit e Spitalit të spitalit tuaj përgjegjës që të përfundojnë mjekimin tuaj të mbikëqyrrur në komunitet. Ju mund të bëni këtë në çdo kohë. Drejtuesit e Spitalit janë komision i veçantë i hapur brenda spitalit për të vendosur nëse njerëzit akoma kanë nevojë për mjekim të mbikëqyrrur në komunitet.

Spitali i juaj përgjegjës është zakonisht spitali në të cilin keni qenë para se të kaloni në mjekim të mbikëqyrrur në komunitet. Ju do të njoftoheni nëse spitali i juaj përgjegjës ndërrohet.

Nëse dëshironi që Drejtuesit e Spitalit të përfundojnë mjekimin tuaj të mbikqyrur në komunitet, ju mund t'ju shkruani në adresën:

Drejtuesit e Spitalit mund të bisedojnë me ju para se të marrin vendim për përfundimin e mjekimit të mbikëqyrur në komunitet.

Anëtari i juaj më i afërm familjar poashtu mund t'ju shkruaj Drejtuesve të Spitalit për t'ju thënë se ju ata dëshirojnë që t'ju përfundoj mjekimi i mbikëqyrur në komunitet. Kjo letëpalosje ju shpjegon më poshtë se cilët janë anëtarët më të afërm të familjes tuaj.

Nëse anëtari juaj më i afërm familjar e bënë këtë, mjekimi i juaj i mbikëqyrur në komunitet do të përfundoj pas 72 orëve, përveç nëse klinicisti i juaj përgjegjës thotë Drejtuesve të Spitalit se ju mund të jeni rrezik për vetëveten dhe për njerëzit tjerë nëse iu ndalohe mjekimi i mbikëqyrur në komunitet. Nëse ndodhë kjo, atëherë anëtari i juaj më i afërm nuk do të mund të kërkoj nga Drejtuesit e Spitalit që t'ju përfundojnë mjekimin e mbikëqyrur në komunitet edhe për gjashtë muaj.

Ju mund të kërkonin nga Tribunal që të pohoj se mjekimi i juaj i mbikëqyrur në komunitet duhet të përfundoj.

### **Ç'është Tribunali dhe çfarë ndodhë?**

Tribunali është një kuadro e pavarur e cila mund të vendos nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Ky kuadër do të mbajë një mbledhje me ju dhe me stafin që ju njeh juve. Kjo mbledhje quhet "seancë". Nëse doni ju mund të kërkonin nga një person të vjen në seancë për t'ju ndihmuar. Para seancës, anëtarët e Tribunalit do të lexojnë raportin lidhur me ju dhe kujdestarinë tuaj. Njëri nga anëtarët e Tribunalit do të vijë të flas me ju.

### **Kur mund të aplikoj tek Tribunali?**

Ju mund të aplikoni tek Tribunali një herë gjatë gjashtë muajve të parë të mjekimit të mbikqyrur në komunitet në çdo kohë. Pastaj ju mund të aplikoni përsëri edhe një herë pas gjashtë muajve të tjerë, dhe përsëri nga një herë në çdo vit gjatë qëndrimit tuaj në mjekimin e mbikqyrur në komunitet.

Nëse anëtari i juaj më i afërm familjar i ka njoftuar Drejtuesit e Spitalit se ata dëshirojnë të përfundojnë mjekimin tuaj të mbikqyrur në komunitet, por klinicisti i juaj përgjegjës thotë se mjekimi nuk duhet të përfundoj, atëherë anëtari juaj më i afërt poashtu mund të aplikoj tek Tribunali. Anëtari më i afërm familjar duhet të aplikoj brenda 28 ditëve për të treguar

se klinicisti i juaj përgjegjës nuk mendon se mjekimi i juaj i mbikqyrur në komunitet duhet të përfundoj.

Nëse dëshironi të aplikoni tek Tribunali, ju mund t'i shkruani në adresën:

The Tribunals Service(Shërbimit i Tribunalit)  
PO BOX 8793  
5th Floor  
Leicester  
LE1 8BN  
Tel. 0300 123 2201

Ju mund të kërkonte nga avokati t'i shkruaj Tribunalit për ju dhe t'ju ndihmoj në seancë. Autoriteti i shërbimeve sociale dhe shoqata e drejtësisë kanë një listë të avokatëve të specializuar për këtë çështje. Ju nuk duhet të paguani avokatin për këtë ndihmë. Ky shërbim është falas në bazë të skemës për Ndihmë Ligjore.

### **Njoftimi i anëtarit më të afërm familjar**

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si anëtarin tuaj më të afërm familjar.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërm familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejta ka anëtari i juaj më i afërm familjar në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërm familjar është:

Nëse nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni klinicistit përgjegjës, një anëtar tjetër të stafit ose personit që ua ka dhënë këtë fletëpalosje.

### **Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar**

Nëse mendoni se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet si anëtari i juaj më i afërm familjar, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të marrë parasysh një person

tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

### **Kodi Praktik**

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thotë Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

### **Si të ankohem?**

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Ju poashtu mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

### **Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm**

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkonit nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkonit një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.